

V E N D I M
Nr.459, datë 2.11.2000

PËR CAKTIMIN E PAGAVE TË ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Në mbështetje të nenit 5 pika 9 dhe pika 11 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, si dhe të neneve 88 e 92 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

I. Paga e Kryetarit të Komisionit të Shërbimit Civil është i barbartë me atë të Grupit A6 të lidhjes nr.1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.378, datë 14.7.2000 “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992 “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”.

II. Paga e anëtarit të Komisionit të Shërbimit Civil është e barabartë me atë të grupit A8 të lidhjes nr.1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.378, datë 14.7.2000 “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992 “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.